

VENDIM
Nr.1037, datë 15.12.2010

**PËR ZBATIMIN E NOMENKLATURËS “SHQIPËRIA NË 3 (TRI) RAJONE NUTS II”,
SIPAS NOMENKLATURËS SË NJËSIVE TERRITORIALE PËR STATISTIKAT
(NUTS)¹, TË BASHKIMIT EUROPIAN**

Në mbështetje të nenit 100 të Kushtetutës, të paragrafit të dytë të pikës 7 të nenit 71 të Marrëveshjes së Stabilizim-Asocimit, ratifikuar me ligjin nr.9590, datë 27.7.2006 “Për ratifikimin e Marrëveshjes së Stabilizim-Asocimit, ndërmjet Republikës së Shqipërisë dhe Komuniteteve Europiane e shteteve të tyre anëtare” dhe të nenit 1 të ligjit nr.8653, datë 31.7.2000 “Për ndarjen administrativo-territoriale të njësive të qeverisjes vendore në Republikën e Shqipërisë”, me propozimin e Ministrit të Integritetit, Këshilli i Ministrave

VENDOSI:

1. Zbatimin e nomenklaturës “Shqipëria në 3 (tri) rajone NUTS II”, sipas nomenklaturës së njësive territoriale për statistikat, niveli NUTS II, të Bashkimit Europian.

2. Tri rajonet janë:

- a) Durrësi dhe Veriu;
- b) Tirana dhe Elbasani;
- c) Jugu.

3. Në zbatim të kësaj nomenklature, organizimi territorial statistikor brenda territorit të Republikës së Shqipërisë do të jetë sipas nivelit NUTS II.

4. Ngarkohen Instituti i Statistikave, ministrinë e linjës dhe institucionet qendrore për zbatimin e këtij vendimi, me qëllim përgatitjen e shifrave të produktit të brendshëm bruto për frymë, të harmonizuara me shifrat e nivelit NUTS II, brenda vitit 2011.

Ky vendim hyn në fuqi pas botimit në Fletoren Zyrtare.

KRYEMINISTRI
Sali Berisha

¹ Rregullore (KE) nr.1059/2003 e Parlamentit Europian dhe e Këshillit, datë 26 maj 2003, për krijimin e një klasifikimi të përbashkët të njësive territoriale për statistikat (NUTS), (Gazeta Zyrtare L 154, 21.6.2003), e ndryshuar me rregulloren (KE) nr.105/2007, datë 1 shkurt 2007, për ndryshimin në shtojcat e rregullores nr.1059/2003 (KE), për krijimin e një klasifikimi të përbashkët të njësive territoriale për statistikat (NUTS), (Gazeta Zyrtare L 39, 10.2.2007).